UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 32, datë 29.12.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", ministri i Financave dhe drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Mediave Audiovizive,

UDHËZOJNË:

1. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) caktohet agjent për vjeljen e tarifës së shërbimit të transmetimeve raditelevizive.

2. Llogaritjet teknike të tarifës bëhen nga AMA sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e agjentit të mbledhjes së kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklarimet;

b) të paguajë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin, zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit të ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga AMA, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. AMA duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifat.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Për shërbimin e kryer, AMA mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar. AMA vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni, duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifat për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton, si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

5. Udhëzimi nr. 36, datë 11.11.2008, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive", shfuqizohet.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

KRYETAR I AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHTOJCA NR.1
TARIFAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë:

1. Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor:

a) me fuqi të rrezatuar deri në 10 W 1500 lekë në vit;

b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 W 6000 lekë në vit;

c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000 W 24 000 lekë në vit;

ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10 000 W 48 000 lekë në vit;

d) me fuqi të rrezatuar mbi 10 000 W 60 000 lekë në vit.

2. Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore:

a) me fuqi të rrezatuar deri në 10 W 300 lekë në vit;

b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 W 1200 lekë në vit;

c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000 W 4800 lekë në vit;

ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10 000 W 9600 lekë në vit;

d) me fuqi të rrezatuar mbi 10 000 W 12 000 lekë në vit.

3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1/b, 1/c, 1/ç, 1/d, 2/b, 2/c, 2/ç, 2/d, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.

4. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1/b, 1/c,1/ç, 1/d, 2/b, 2/c, 2/ç, 2/d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur mbi këto pika shumëzohet me koeficientin 2.

5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1/b, 1/c, 1/ç, 1/d, 2/b, 2/c, 2/ç, 2/d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50 000 deri në 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1.5.

6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1/b, 1/c,1/ç, 1/d, 2/b, 2/c, 2/ç, 2/d, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.

7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga AMA paguajnë vetëm 20 për qind të tarifave të përcaktuara më sipër.